6		F.v pllaka grez për ballkone ( jo rrëshqitëse )	m <sup>2</sup>	266.60		

7	F.v Plintusa pllake grez perimetrare, h=10cm	ml	58.10		
8	F.v Veshje e fasadës në vendin e tubave me gips çimentato	m <sup>2</sup>	38.40		
9	F.v. Ulluk për shkarkimet me tuba Φ100mm	ml	57.00		
10	F.v. Ulluk për shkarkimet me tuba Φ150mm	ml	57.00		
11	F.v. Brryla Φ100mm + Φ150mm	cope	30.00		
12	F.v Kasata shkarkimi të reja	cope	10.00		
13	Vendosje e tubit Φ150mm me sifon në rast prurje shumë të madhe që del mbi plintusa	cope	2.00		
14	Shkarkim vertikal me tub Φ150mm	ml	5.55		
15	F.v suva grafiato në zonat e fasadës ku janë bërë riparimet me gips	m <sup>2</sup>	38.40		
<b>Shuma 2</b>		<b>Leke</b>			
<b>3. Punime për lyerjen e ambienteve të godinës</b>					
1	Patinim muri allçi (stuko).	m <sup>2</sup>	62.00		
2	F.v Lyerje me bojë ekologjike plastike anti-myk	m <sup>2</sup>	62.00		
3	F.v Lyerje me bojë hidroplastike importi, cilësi e parë. Ambientet e brendshme të godinës, mure dhe tavane (pa katin -1)	m <sup>2</sup>	13,098.00		
4	F.v Lyerje me bojë importi akrilik, cilësi e parë, për ambientet e jashtme të godinës	m <sup>2</sup>	147.98		
<b>Shuma 3</b>		<b>Leke</b>			
<b>4. Riparime të Vetratave të Dritareve kundër lageshtirës</b>					
1	Kruarje + pastrim të silikonit egzistues në vetratat e dritareve, kati 0.0 dhe kati +1. Pastrimi të bëhet në të gjithë perimetrin e dritareve	o.p	32.00		
2	Vendosje silikonit tip Polymax, 115g, Crystal në vetratat e dritareve, kati 0.0 dhe kati +1. Silikonimi të bëhet pasi sipërfaqja të jetë kruajtur dhe pastruar mirë.	o.p	48.00		
3	Vinc kulle 4-6 T	o.p	48.00		
4	Riparime të plintusave prej druri ne dysHEME teknologjike	ml	40.00		
5	Heqje të rimesove të drurit në dritare, që janë të dëmtuara nga prezenca e lageshtirës	m <sup>2</sup>	103.05		
6	F.v Rimeso druri në dritare, 50cp (5.57*0.25*0.12) m	m <sup>2</sup>	103.05		
7	Silikon Polymax, 115 g, Crystal	cope	40.00		
<b>Shuma 4</b>		<b>Leke</b>			
<b>Shuma A (1 + 2 + 3 + 4)</b>		<b>Leke</b>			
<b>B RIPARIMI I MAGAZINËS</b>					
<b>1. Punime për Riparimin e Magazinës</b>					
1	Demontim të derës së hyrjes e dëmtuar	m <sup>2</sup>	24.50		
2	F.v. Derë Metalike kryesore për hyrjen në magazinë	m <sup>2</sup>	24.50		
3	Kornizë kulmore llamarine çatie xingat mbi panelin sanduiç b=60 cm	m <sup>2</sup>	76.00		
4	F.v. Ulluk shkarkimi horizontal me llamarinë xingat	ml	90.00		
5	F.v. Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat Ø 100	ml	184.00		

6	F.v. Panele Sandwich për muret anësore të magazinës	m <sup>2</sup>	340.00		
7	Kontroll i plotë i paneleve egzistuese sanduiç dhe fiksime më të mira të tyre me aksesore shtesë në zonat ku është e nevojshme	m <sup>2</sup>	2,140.00		
8	F.v. Profile Metalike - Përforcime shtesë me elemente metalike tip "C" në mure dhe në mbulesë	ton	3.13		
<b>SHUMA 1</b>		<b>Leke</b>			
<b>Shuma A+B</b>		<b>Leke</b>			
<b>Fondi Rezervë 5%</b>		<b>Leke</b>			
<b>Shuma</b>		<b>Leke</b>			
<b>TVSH</b>		<b>Leke</b>			
<b>SHUMA TOTAL</b>		<b>Leke</b>			

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kërkuar në dokumentat e tenderit )

Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik )

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]



---

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/ Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

**Objekti:** "Mirëmbajtja e Ambienteve të Brendshme dhe të Jashtme të Administratës Qëndrore të OST sh.a" si dhe Riparimi i ambienteve të Magazinës "N/Stacioni 400kV/Tirana 2 Kashar".

**Vendndodhja:** Rruga dytësore Tiranë-Durrës, km 9, Kashar, Lagjja Yrshek, Tiranë.

Ky dokument të konsiderohet si pjesë përbërëse e dokumentacionit të Projektit Zbatimit dhe Preventivit Perfundimtar per objektin e mësipërm.

Informacioni i dhënë këtu ka për qëllim specifikimin e punimeve dhe instalimeve, në mënyrë që ato të jenë saktësisht në përputhje me standardet e kërkuara për të përmbushur objektivat e projektit. Këto specifikime teknike duhet të lexohen së bashku me çdo detaj shtesë të përmendur në:

- Vizatimet referuar fleteve te projekt-zbatimit.
- Raporte apo Skeda Teknike te materialeve ndertimore.
- Preventivat e Punimeve.

Kontraktori apo Zhvilluesi i Punimeve duhet t'i referohen specifikimeve teknike të atyre zërave të punimeve te cilat perfshihen ne pershkrimet e vizatimeve, tipologjine e punimeve si dhe ne preventivin perfundimtar.

Përshkrimet në këto specifikime tregojnë një gamë produktesh nga të cilat kontraktori mund të zgjedhë për të propozuar ne marreveshje me kontraten.

Në përgjithësi të gjitha pajisjet përfshijnë instalimin në kantier: blerjen, transportin, magazinimin, përgatitjen, punimet e përkohshme duke përfshirë edhe ngritjen e tyre, mirëmbajtjen dhe heqjen; të gjitha pajisjet e kërkuara për të siguruar punimet, të gjitha pajisjet e kërkuara për të siguruar mjaftueshëm siguri mbi shëndetin në kantier dhe në afërsi të tij, instalimin duke përfshirë të gjithë punimet dhe makineritë, pastrimin, mbrojtjen e objektit deri në dorëzimin e tij dhe gjithçka që ka lidhje me të, skicat (nëse ka), të gjitha në bazë të specifikimeve dhe pritshmërive të 'praktikave të mira të punës' Standartet e perdorura ne keto "Specifikime Teknike" dhe qe do te aplikohen me tej nuk mbeshteten vetem ne vizatimet, por edhe ne manualet ligjore dhe libra te tjere keshillues si:

• Manuali Nr.1 "Analizat Teknike Prodhimi i Materialeve te Ndertimit", Tirane -15.07.2015 (Republika e Shqiperise –Drejtoria e Pergjitheshme e Tatimeve, Ministria e Transportit dhe Infrastruktures, Këshilli i Ministrave).

• Manual Nr.2, Nr.3, Nr.4 per "Analiza Teknike per Punimet e Ndertimit te Ndertesave", Tirane (Republika e Shqiperise –Drejtoria e Pergjitheshme e Tatimeve, Ministria e Transportit dhe Infrastruktures, Këshilli i Ministrave me Nr.629, date 15.07.2015).

### SPECIFIKIME TE PERGJITHSHME

#### Specifikime te pergjithshme

##### Njesite matese

Ne pergjithesi njesite matese kur lidhen me Kontratat jane njesi metrike ne mm, cm, m, m<sup>2</sup>, m<sup>3</sup>, Km, N (Njuton), Mg (1000 kg) dhe grade celcius.

Proçeset e punimeve qe do te kryhen, per te arritur qellimin e investimit, do te kalojne ne keto faza:

#### PUNIME PRISHJEJE

##### Punime prishje dhe demontimi per ballkonet panoramik

---

Nga sondazhet dhe vzhgimet e bera rezulton qe rrjedhja e ujit ne ambientet e brendshme te godines se administrates qendrore te OST sh.a, ka ardhur si rezultat i mosfunksionimit te shkarkimeve egzistuese qe mbledhin ujrata e tarraces dhe e nxjerrin ne katin 0.0. Keto tuba shkarkimi jane te vendosur brenda sistemit termoizolues dhe jane te maskuar, ç'ka e ben te veshtire survejimin e tyre per te evidentuar me thelle problemin. Dyshohet qe problemi mund te jete tek pjesa ku behet kalimi i shkarkimeve me brryl nga vertikal ne horizontal. Brryli lidhes mund te kete pesuar demtime ose carje si rezultat ndoshta dhe i lekundjeve sizmike para disa viteve. Per kete arsye duhet te behet hapja e tarraces se ballkoneve me qellim zevendesimin e tyre me tuba te rinj. Faza e punimeve per kete proces do te jete:

- Çarje e kolonave te maskuara te verandave per te zbuluar tubat e shkarkimeve (kati +1, kati 0.0)
- Heqje te pllakave grez egzistuese
- Heqje te paketes h/izoluese te verandave
- Heqje te sistemit te shkarkimeve sipas shtrirjes horizontale deri ne dalje te buketoneve
- Pastrim te plote te tarraces dhe transportimi i materialeve te nxjerra drejt ambienteve te jashtme

Në pjesen e ballkoneve, pllakat dhe shtresat që ngjisin pllakat te behet me kujdes me vegla qe nuk krijojne demtim te struktures mbajtese. Demontimi i shtresave mbrojtese te tarraces se ballkoneve perfshin, heqjen e shtresave te çfaredo natyre, duke perfshire materialin mbushes per dhenie pjerresie si dhe shtresat e tjera qe ekzistojne. Gjithashtu prishje te shtresës horizontale te hidro-izolimit te tarraces me zhvillime vertikale apo ne pranine e oxhaqeve (nese ka), e ndertuar nga shtresat e mbivendosura leter katrama , duke perfshire heqjen e kapakeve te parapetit e te çdo pjese metalike dhe venien menjane e spostimin ne kantier te materialeve qe formohen, si dhe çdo detyrim tjetër për t'i dhene fund plotesisht heqjes se tarracës.

Ky proces duhet te realizohet ne kohe te thate, pa lageshti dhe brenda kondicioneve teknike te ndertimit. Transportimi i materialeve te nxirren jashte objektit dhe te transportohen drejt vendeve te percaktuara nga organet vendore.

Kontraktori, duhet te paguaje çdo demtim te bere gjate procesit te punimeve apo transportit te materialeve, dhe nese eshte e nevojshme duhet te paguaje kompensim.

Kontraktori duhet te vendose barriera mbrojtese, ne menyre qe te parandaloje aksidentime te personave apo prezence te njerezve, si dhe te mbaje nen kontroll territorin, ku do te kryhen punimet. Gjithashtu duhet pasur kujdes qe te parandalohet shperndarja ose renia e materialeve, ose te projektohet ne menyre te tille, qe mos te perbeje rrezik per njerezit.

Rrugët pranë objektit duhet të mbahen të pastra çdo ditë. Kontraktori duhet të ndërmarrë masat e nevojshme për të parandaluar ndotjen, si për shembull pastrimin e gomave dhe mbulimin e kamionëve me karroceri të hapura me materiale që largohen nga kantieri.

## **PUNIME PER RIPARIMIN E AMBIENTEVE TE JASHTME**

### **Punime per Riparimin e Ballkoneve Panoramik**

Pasi eshte bere heqja e gjithe shtresave egzistuese te tarraces, pastrimi dhe kuarja e mire e siperfaqes do te kalohet ne vendosjen e paketes se re termo-izoluese.

Procesi do te filloje me shtrirjen e shkarkimeve te reja ne projektionin vertikal qe vijne nga tarraca drejt soletes se katit +1 dhe me ane te rakorderive apo aksesoreve lidhes, brryla d100mm ose 150mm, do te behet kalimi i tyre ne projektion horizontal. Zhvillimi i tyre do te behet perseri ne projektion vertikal deri ne daljen finale ne katin perdhe. Fiksimi te behet sipas normativave te ndertimit me fasheta metalike ne kolone sipas projektionit vertikal dhe ne solete sipas drejtimit horizontal te fiksuar me tel xingato. Tubat PVC sipas DIN 8061 – 8062 kane perdorim te gjere ne shkarkimin e ujrave komunale, hidrosanitare dhe ujrave te shiut. Tubat e kesaj kategorie ofrohen pergjithesisht per transportin e ujit me dhe pa presion. Bashkimi behet me gote dhe material ngjites. Bashkimi i thjeshte dhe i shpejte e ul koston e montimit dhe siguron plotesisht mosrrjedhjen ne vendet e bashkimit. Nuk shformohet dhe demtohet si dhe transportohen dhe montohen lehtë dhe shpejt per arsye te peshes se tyre të vogël. Nuk krijohen frenime, per arsye te siperfaqes se brendshme te lëmuar dhe perberjes kimike qe ka materiali i tyre. Kanë rezistencë shumë të

---

lartë mekanike në superngarkesat (grushte hidraulike). Kanë jetëgjatësi shumë të madhe. Te behet vendosja e kasetave te reja te sistemit te drenazhimit dhe cdo gje tjeter per te garantuar funksionimin normal te rrjedhjes se ujrave. Gjithashtu te behet hapja ne parapetin e murit e nje vrime mbi kuoten e plintusit qe do te sherbeje si shfryrje dhe nxjerrje te ujrave ne rastin me ekstrem te bllokimit apo mosfunksionimit te tubave apo kasetave te shkarkimit.

**Shtrese termozolimi** 10 cm me polisterol EPS, e vendosur me panele 60mmx1250mm (mbi shtresen avullizoluese gjeotekstil). Koeficienti i përcjellshmërisë termike 0.038 (W/mK). Panel termoizolues me ngjyrë blu ose te bardhe, realizon termoizolim perfekt, eshte rezistente ndaj absorbimit te lageshtires, ka rezistencë të lartë në shtypje, veti shumë të mira akustike, montohet fare lehtë fale paturave në kater anet, si dhe ka qendrueshmëri dimensionale ne kohe dhe gjate ndryshimit te temperatures.

Me pas do te behet formimi i pjerresive mbi siperfaqen plane me nje shtresë llaç-çimento me trashësi deri ne 30mm, për te pasur një pjerrësi sipas udhëzimeve ne projekt, e perbere nga rere e larë (porozitet 35%) e çimento, në raporte 1:2 me dozature Çimento 527 kg (tipi 400). rërë m<sup>3</sup> 0,89. Kësaj shtrese i jepet pjerrësi 2%. Spesori minimal duhet te jete 2-3cm, e niveluar ne menyre perfekte per pregatitjen e siperfaqes ku do te vendoset polisteroli.

**Shtrese hidro-izoluese 2KK**, mbi sipërfaqe te thare dhe të niveluar si me siper me llaç-çimento, duke përfshire dhe pjesën vertikale, trajtuar me nje dore praimerit, e përberë nga dy membrana me trashësi 3 mm secila, te vendosura në vepër me flake, te kryqëzuara mbi siperfaqe te rrafshet, te pjerrët ose vertikale, përfshire mbivendosjen e lidhjeve (minimumi prej 12 cm) deri ne kompletimin final te punimeve. Mbrojtja e membranës h/izoluese do te behet me llaç-çimento duke aplikuar dhe fugaturat.

**Shtrese me pllaka grez** (jo te rreshqitshme)

E aplikuar mbi siperfaqet e percaktuara ne V.T., te cilesise se pare te tipit te zgjedhur, perfshire:

- Ngjitjen e pllakave qe realizohet me shtrese kolle,
- Prerjen me prerës pllakash dhe ngulitjen e inkastrimeve ne mur, vendosjen ne veper ne menyre plotesisht te ngjeshur ndermjet tyre dhe te stukuara me bojake çimentoje ne fugatura,
- Larjen dhe pastrimin,
- Çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te dyshemese ne menyre perfekte.

Vendosja e plintusave me lartesi 8-10cm dhe trashesi 1,5 cm, te vendosur ne veper me kolle, duke perfshire stukimin, pastrimin si dhe çdo detyrim tjeter per mbarimin e plote te punes ne menyre perfekte.

**Veshje me gips çimentato**

Pasi kompletohen punimet e fiksimit te tubave te shkarkimit PVC do te behet mbyllja e hapësirave me strukture gips-çimentato, ne projeksionin vertikal qe shtrihet ne dy katet (+1 dhe 0.0). Perdorimi i kartongipsit lejohet kryesisht ne ambiente te thata, por rralle edhe ne ambiente me lageshtire. Ne rast te perdorimit ne ambiente me lageshtire, pllakat e gipskartonit duhet te kene shenje te veçante nga prodhuesi, me te cilen lejohet perdorimi i tyre ne ambiente te tilla. Sistemi i ndertimit te struktrures se maskimit perbehet nga pllaka e gipsit me dimensione 62.5 cm x 250 cm dhe 125 cm x 250 cm, kurse trashesia eshte 12,5 mm ose 15 mm. Materiale te tjera pjese perberese janë profilet, vidat, gozhdat, rripi i mbylljes së fugave, pluhur gipsi për të mbushur fugat, etj...Sistemi i murit prej gipsi mund te perpunohet si çdo mur tjeter, ne te aplikohet suvatimi dhe lysterja finale me boje.

**Suvatim me grafiato**

Para aplikimit te grafiatos fasada duhet te jete e plotesuar. Produkti i grafiatos se gatshme eshte ne forme pluhuri i cili perzihet me uje derisa formohet nje mase homogjene lehtesisht e aplikueshme. Para aplikimit te grafiatos, vendoset paragrafiato e cila duhet te jete mire e sheshuar dhe e niveluar. Menjehere pas aplikimit te produktit ne fasade, behet rrafshimi i tij me nje malle plastike dhe punohet ne drejtim vertikal. Gjate aplikimit te produktit duhet patur parasysh qe temperatura e ambientit te jete me e madhe se 5 °C.

---

Ne prani te temperaturave te larta produkti mbas aplikimit duhet te sperkatet me uje per te menjanuar humbjet e ujit. Suvatimi graffiato me trashesi 3 mm me dorezim per m<sup>2</sup> graffiato e gatshme kg 5. Ngjyrat jane te percaktuara ne projekt dhe para fillimit te punimeve duhet marre konfirmimi i investitorit.

## **PUNIME BOJATISJE**

### **Patinimi**

Patinatura e mureve të brendshme realizohet me stuko të cilesise se larte, mbi siperfaqe te suvatuara me pare dhe te niveluara. Patinatura konsiderohet e perfunduar dhe e gatshme per t'u lyer me çdo lloj boje, kur siperfaqja eshte e sheshtë dhe kur nuk ka ka gervishtje.

### **Lyerje me boje plastike e siperfaqeve të brendshme**

Proçesi i lyerjes me boje plastike, cilesia e pare importi, per siperfaqet e brendshme (mure dhe tavane) kalon neper tre faza si me poshte:

1- Pergatitja e siperfaqes qe do te lyhet. Para lyerjes duhet te behet pastrimi i siperfaqes, mbushja e gropave te vogla apo demtimeve te siperfaqeve me ane te stukimit me material sintetik dhe bërja gati per paralyerje. Ne rastet e siperfaqeve te patinuara behet nje pastrim i kujdesshem i siperfaqes. Para fillimit te proçesit te lyerjes duhet te behet mbrojtja e siperfaqeve qe nuk do te lyhen: (dyer, dritare, etj) me ane te vendosjes se letrave mbrojtese.

2 - Paralyerja e siperfaqes se brendshme te pastruar. Ne fillim te proçesit te lyerjes behet paralyerja e siperfaqeve te pastruara mire me vinovil të holluar (Astar plastik). Per paralyerjen behet perzierja e 1 kg vinovil me 2.5-3 litra uje. Me perzierjen e pergatitur behet paralyerja e siperfaqes vetem me nje dore. Norma e perdorimit eshte 1 liter perzierje vinovil me uje duhet te perdoret per 20 m<sup>2</sup> siperfaqe.

3 - Lyerja me boje plastike, cilesi e pare importi, per siperfaqet e brendshme. Ne fillim behet pergatitja e perzierjes se bojës plastike e cila eshte e paketuar ne kuti 5-10-15 litershe. Lengu i bojës hollohet me uje ne masen 20-30 %. Kesaj perzierje i hidhet pigmenti derisa te merret ngjyra e deshruar dhe e aprovuar nga Supervizori i punimeve dhe pastaj behet lyerja e siperfaqes. Lyerja behet me dy duar. Norma e perdorimit eshte 1 liter boje plastike e holluar duhet te perdoret per 4-5 m<sup>2</sup> siperfaqe. Kjo norme varet nga ashpersia e siperfaqes se lyer. Personeli, qe do te kryeje lyerjen duhet te jete me eksperience në kete fushe dhe duhet te zbatoje te gjitha kushtet teknike te lyerjes te KTZ dhe STASH.

### **Lyerje me boje akrelik i siperfaqeve te jashtme**

Riparimet finale me boje, pas aplikimit te grafiatos ne siperfaqet e jashtme ku jane bere riparimet.

Para lyerjes duhet te bëhet mbrojtja e siperfaqeve qe nuk do te lyhen. (dyer, dritare etj) me ane te vendosjes se letrave mbrojtese. Ne fillim te proçesit te lyerjes behet paralyerja e siperfaqeve të jashtme me astar. Kjo boje ndryshon nga boja plastike sepse ka ne perberjen e saj vajra te ndryshme, te cilat e bejne bojen rezistente ndaj rrezeve te diellit, ndaj lageshtires se shirave, etj. Ne fillim behet pergatitja e perzierjes se bojës akrelik me uje. Lengu i bojës hollohet me uje ne masen 20-30 %. Kesaj perzierje i hidhet pigmenti deri sa te merret ngjyra e deshruar. Pastaj, behet lyerja e siperfaqes. Lyerja behet me dy duar. Norma e perdorimit eshte 1 liter boje akrelik i holluar në 4-5 m<sup>2</sup> siperfaqe (ne varese te ashpersise se siperfaqes se lyer). Personeli, qe do te kryeje lyerjen duhet te jete me eksperience në kete fushe dhe duhet te zbatoje te gjitha kushtet teknike te lyerjes te KTZ dhe STASH.

### **Trajtimi i siperfaqeve te demtuara nga lageshtira**

Si rezultat i depertimit te ujrave nga jashte eshte verejtur demtimi i pjesshem i rimesove te drurit ne pjesen e brendshme te dritareve, ç'ka ka sjelle deformim te tyre. Ne zonat ku ka prezence te theksuar te lageshtires nga brenda do te behet trajtimi i siperfaqeve duke i pastruar, patinuar dhe me pas duke i lyer me solucion antimyk. Me pas do te zevendesohen kornizat me rimeso te reja druri. Paralelisht do te behet kruarja, pastrimi me furce i silikonit te vjeter neper dritare. Materiali i ri do te jete silikon ngjites dhe mbushes universal transparent kristal i prodhuar me teknologjiine unike te Polymer. Per te ngjitur dhe mbushur praktikisht ne te gjitha llojet e materialeve te ndertimit dhe siperfaqet qe jane poroze apo te

---

lemuar. Te jete per perdorim per montime ne parvazet e dritareve, te mbushe dhe te izoloje: kornizat e dritareve, hapsirat e gipseve etj. Aplikimi ndermjet temperaturave +5°C dhe +40°C. Siperfaqja duhet qe te jete e thate dhe e paster nga pluhuri apo papasterti te tjera.

## **PUNIME PER RIPARIMIN E AMBIENTEVE TE MAGAZINES – Nenstacioni 400 kV/Tirana 2 Kashar**

Magazina ne nenstacionin 400 kV Tirana 2 Kashar ka pesuar demtime dhe si rezultat kerkon nje kontroll per perforcimin shtese te elementeve te konstruksionit, ku perfshihen panelet Sandwich te cilat jane te shkeputura dhe duhen fiksuar ne vendet ku eshte e nevojshme.

Per kete arsye me ane te nje vinçi me kosh duhet te behet monitorimi dhe kontrolli i plote i gjithe siperfaqes, tavane dhe mure dhe te behen kapje ose mberthime shtese per te mundesuar rritjen e qendrueshmerise si dhe per te rezistuar ndaj agjenteve atmosferike.

Do te vendoset e re kulmorja e catise se magazines.

### ***Materialet e perdorura***

- Te gjitha materialet, dimensionet e tyre, format, peshat, tolerancat e vetive kimike dhe mekanike, do te perputhen me standartet perkatese ose me te tjera te ngjashme te miratuara.
- Kontraktori do te jete pergjegjes per korrektesine e detajeve te tij.
- Te gjitha konstruksionet e çelikut do te jene te padeformuara, te drejta dhe pa çarje, kthesa dhe papasterti.

Elementet C te veshjes se magazines rekomandohet te lidhen me bulona dhe jo me saldim, por kjo do te vendoset ne projekt zbatimin e magazines. Dera metalike e objektit magazine do te ribehet dhe duhet te tregohet kujdes me pikat e fiksimit dhe rulat rreshqites te saj.

### ***Shkarkimet e Ujrave***

Elementet perberes te tarraces jane: Ulluqet vertikale dhe horizontale

#### **Ulluqet horizontale**

Realizohen me pjerrresi prej 1% per largimin e ujrave. Ulluqet horizontale prodhohen me material plastik ose me llamarine xingato. Ulluku me llamarine prej çeliku te xinguar me trashesi jo me te vogel se 0,8 mm, i formuar nga pjese te modeluara me mbivendosje minimale 5 cm, te salduara ne menyre te rregullt me kallaj, me bord te jashtem 2 cm me te ulet se bordi i brendshem, te kompletuara me pjese speciale per gryken e hyrjes. Ulluku horizontal, i modeluar sipas udhezimeve ne projekt, duhet te jete i lidhur me tel xingato me hallka të forta te vena maksimumi ne 70 cm. Ulluket e vendosur ndermjet çatise dhe parapetit do te jenë prej llamarine te xinguar, sipas detajeve të vizatimit.

#### **Ulluqet vertikale**

Jane per shkarkimin e ujrave te çatave dhe taracave, dhe kur jane ne gjendje jo te mire duhet te çmontohen dhe te zevendesohen me ulluke te rinj. Ulluqet vertikale per shkarkimin e ujrave te çatave dhe taracave qe pergatiten me llamarinë prej çeliku te xinguar, duhet te kene trashesi jo me te vogel se 0.6 mm dhe diameter 10 cm, kurse ulluqet vertikale prej PVC kane dimensione nga 8 deri në 12 cm dhe mbulojne nje siperfaqe çatie nga 30 deri në 60 m<sup>2</sup>. Ne çdo ulluk duhet te mblidhen ujrat e nje siperfaqe çatie ose tarace jo me te madhe se 60 m<sup>2</sup>. Ulluket duhet te vendosen ne pjesen e jashtme te nderteses, me ane te qaforeve perkatese prej çeliku te xinguar, te fiksuar çdo 2 m.

---

Pjesa fundore e ulluqeve, per lartesine 2 m, duhet te jetë PVC dhe e mberthyer fort me ganxha hekuri si dhe poshte duhet te kthehet me brryl 90 gradë dhe do te derdhen jashte trotuarit te objektit, detaji I vendosjes do te aprovohet nga investitori.

Te gjitha materialet qe do te vendosen ne objekt bashke me skeden teknike do te aprovohen nga mbikëqyresi i punimeve para se te vendosen ne veper dhe te jene te shoqeruara me çertifikate cilesie dhe konformiteti.

Te gjitha punimet te behen ne përputhje te plote me rregullat edhe kushtet teknike ne fuqi ne RSH-së, qe rregullojne veprimtarine ne fushen e ndertimit.

**Shënime:**

- i. Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.**
- ii. Kudo ne Specifikiet Teknike ku eshte cituar standard nderkombetar, do te pranohet edhe cilësim ekuivalent nga një institut vendor.**

---

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/ Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/ kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE**

**Afatet e realizimit të punimeve: 1 (nje) muaj nga hyrja ne fuqi e kontrates.**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3. Afati i realizimit</i>				
<b>Nr</b>	<b>Përshkrimi i Punëve</b>	<b>Java 1/Muaji 1</b>	<b>Java 2/Muaji 2</b>	<b>Java 3/Muaji 3</b>	<b>Java 4/Muaji 4</b>	<b>Java 5/Muaji 5</b>
1.						
2.						
3.						
4						

Shënim. Autoriteti/ kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.



## Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

#### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- 
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

*Sipas pikes 1 te kesaj shtojce.*

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

- 2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, te paktën 4,500,000 (kater milion e peseqind mijë) Leke.*

*Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.*

*Si prove per plotesimin e ketij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje vertetim nga Administrata Tatimore ku te tregohet xhiroja vjetore per vitet e siperpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitet dhe pasivitet.*

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

- 2.3.1 *Operatori ekonomik ofertues për të provuar përvojën e mëparshme, duhet te ketë realizuar të paktën:*

- a) *punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 3,400,000 (tre milion e katërqind mijë) Leke dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;*
- b) *punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më të vogël se 11,000,000 (njëmbëdhjetë milion) Leke.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Si dëshmi për përvojën e mëparshme, OE Ofertues duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, OE Ofertues duhet të paraqesë si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.*

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur me licence profesionale, ne fushen e zbatimit te punimeve, leshuar nga organet kompetente, e cilat te permbajne kategorite e meposhtme:*

*Punime ndertimi:*

<i>Kategoria NP-2</i>	<i>Ndertime civile dhe industriale</i>	<i>Klasifikimi A</i>
<i>Kategoria NS-1</i>	<i>Punime per prishjen e ndertimeve</i>	<i>Klasifikimi A</i>

***Shenim: Ne rast pjesmarrjeje te nje Operatori ekonomik te huaj, ky i fundit, Licencen e mesiperme me kategorite e pershkruara, duhet ta kete te njehsuar prane organeve perkatese ne Republiken e Shqiperise sipas legjislacionit te saj ne fuqi.***

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete te punesuar minimalisht punonjesit si me poshte vijon:*

- *Si drejtues teknik te perfshire ne licencen e shoqerise te pakten 1 (nje) inxhinier ndertimi, 1 (nje) inxhinier hidroteknik.*
- *Gjithashtu si pjese e stafit te tij ofertuesi pervec inxhinierve te mesiperm duhet te kete dhe 1 (nje) inxhinier mekanik.*

*Inxhinieret e mesiperm duhet te jene te siguruar dhe te figurojne ne listepagesat perkatese E-Sig per 6 (gjashte) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.*

*Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje: kontratat individuale te punes, shoqeruar me diplomat perkatese te inxhinierve te mesiperm, si dhe listepagesat per periudhen e kerkuar.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet te deklaroje me shkrim se inxhinieret e pershkruar ne piken 2.3.3 per kualifikim jane te pa angazhuar ne kontrata te tjera dhe, ne rast se shpallen fitues per kete procedure, do te qendrojne ne objekt gjate gjithe kohes se zbatimit te punimeve.*

*Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte vertetesine e deklarates.*

2.3.5 *Operatori ekonomik ofertues duhet te dëshmoje se ka fuqinë punëtore të nevojshme minimalisht 20 (njëzet) punonjës me kohë të plotë pune, për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Punonjësit duhet te jene te siguruar te pakten për 6 (gjashte) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.*

*Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet listepagesat perkatese E-Sig.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

---

2.3.6 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete ne stafin e tij te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar per punime ne lartesi te siguruar jo me pak se 6 (gjashte) muajt e fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

2.3.7 *Operatori ekonomik ofertues duhet të kenë në stafin e Tij, 1 (një) punonjes që të disponojë certifikatë të trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" i ndryshuar dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" i ndryshuar.*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

2.3.8 *Operatori ekonomik ofertues duhet të kenë ne stafin e tij punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente me te, të vlefshme, minimalisht per periudhen e 6 (gjashte) muajve te fundit nga data e publikimit te njoftimit te kontrates, nga te cilet minimalisht te mbajne profesionet si me poshte vijon:*

- *1 (një) inxhinier hidroteknik;*
- *1 (një) inxhinier ndertimi;*
- *1 (një) murator per mure tulle;*
- *1 (një) bojaxhi per ndërtesa;*
- *1 (një) punëtor krahu;*
- *1 (një) marangoz;*
- *1 (një) saldator per pikime;*
- *1 (një) teknik ndërtimi;*
- *1 (një) hidraulik;*
- *1 (një) punonjës te certifikuar per punime ne lartësi;*
- *1 (një) punonjës te certifikuar per sigurinë dhe shëndetin ne pune.*

*Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues për punonjësit e mësipërm duhet të disponoje kontratat e punës te vlefshme; deshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik, (të vlefshme) si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për periudhen e kerkuar.*

*Përveç si me sipër, per punonjesit teknik ndertimi duhet te paraqitet dokumenti qe verteton kualifikimin (deftese dhe/ose diplome).*

*Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.*

*Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.*

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues per përmbushjen e kontratës duhet te dëshmoj se ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike te nevojshme, si me poshte vijon:

Nr.	Mjetet	Sasia
1	Karroce dore	4 cope
2	Jelek dhe kapele pune	20 sete
3	Litar sigurimi	20 cope
4	Depozite uji	1 cope
5	Matrapik	1 cope
6	Saldatrice	1 cope
7	Betoniere	1 cope
8	Prozhektor	6 cope
9	Kuti e ndihmës se shpejte	1 cope
10	Tabele sinjalizuese	1 cope
11	Fikese zjarri	1 cope
12	Kamion deri ne 15 ton	1 cope

Si deshmi per plotesimin e kesaj pike operatori duhet te disponoje:

1. Per mjetet, makinerite dhe pajisjet në pronësi te paraqitet akti i pronësisë (kontrata shitblerje, fatura tatimore e shitjes ose fatura e zhdoganimit etj.)
2. Per mjetet, makinerite dhe pajisjet me qira të paraqitet kontratë qiraje si dhe akti i pronësisë së qiradhënësit sipas percaktimit te bere me lart.
3. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin (leje qarkullimi akt kolaudimi, siguracion, taksat vjetore, leje transporti dhe çertifikaten e pronësisë se mjetit) dhe foto ku te duket qarte targa e mjetit.
4. Makinerite e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet një deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese se makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë deklaruar në një procedurë tjetër tenderimi në të cilën nuk është shpallur ende fituesi.
5. Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku pranon se Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO, te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:

- ✓ ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë, qe ka lidhje me objektin e prokurimit.
- ✓ ISO 14001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë së mjedisit, qe ka lidhje me objektin e prokurimit.
- ✓ ISO 45001: për Sistemin e menaxhimit të sigurise ne pune, qe ka lidhje me objektin e prokurimit.
- ✓ ISO 39001: per menaxhimin e sigurise se transportit rrugor

---

2.3.11 *Ne funksion te plotesimit te Shtojces 8 "Formulari permbledhes i vetedeklarimit" Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shenim:**

- i. *Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet "markë" përfshihet termi "ose ekuivalenti i tij/saj".*
- ii. *Ne plotesimin e "Formularit permbledhes te vetedeklarimit", ne piken "Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)", OE ofertues duhet te shenoje ne menyre te sakte, si prove paraprake: degen e studimeve te punonjesive, si dhe profilet perkatese te diplomave, qe disponon per plotesimin e kriterave te vecanta te kualifikimit. Keto deklarime do te shqyrtohen kur OE ofertues do te paraqese dokumentet origjinale ose kopje te noterizuara per punonjesit, pas shpalljes fitues se ofertes. Keqinformimi dhe deklarimi i rreme me qellim kualifikimin e ofertes, ne menyre te padrejte, sanksionohet nga pika 1/a, te nenit 78 "Perjashtimi per nje periudhe te caktuar nga Agjencia e Prokurimit Publik", te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik".*

## Shtojca 8.

### FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

#### A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

#### B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

<b>Deklarata</b>
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>



<p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

**B: DEKLARATA “Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura”**

